



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 249/25 Dt. 15.04.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 3 paragrafi 4 dhe nenit 14 paragrafi 1.4 Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, Memorandumit të Bashkëpunimit të lidhur në mes Komunës së Prizrenit dhe OJQ “Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug (AZHR Jug) 01 Nr.200/25, të datës 24.03.2025 dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve për bashkëfinancim të projektit

1. Lejohen mjetet financiare për bashkëfinancim në realizimin (financimin) e projektit që ka për qëllim krijimin e vendeve të reja të punës në komunën e Prizrenit si dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore lokale në komunën e Prizrenit. Ky bashkëfinancim është i bazuar në nenin 3 të Memorandumit të Bashkëpunimit të lidhur në mes Komunës së Prizrenit dhe OJQ “Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug (AZHR Jug) 01 Nr.200/25, të datës 24.03.2025, kështu që, për këtë qëllim Komuna e Prizrenit, në emër të bashkëfinancimit për këtë projekt, lejon mjetet financiare në shumë prej 28.980,00 € (njëzetë e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë).
2. Zyrtar Monitorues i projektit nga Komuna e Prizrenit, caktohet z. Halil Lika.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Memorandumi i Bashkëpunimit të lidhur në mes Komunës së Prizrenit dhe OJQ “Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug (AZHR Jug) 01 Nr.200/25, të datës 24.03.2025.
4. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.
5. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe zyrtari monitorues për zbatimin e vendimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Zyrtarit monitorues,
 - AZHR Jug,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

